



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 101, datë 29.09.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR T’U DREJTUAR KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR NJË NDRYSHIM TË VKM-SË NR. 431, DATË 15.05.2013 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE PËRDORIM TË KOMUNËS KATUNDI I RI, TË QARKUT TË DURRËSIT” DHE MIRATIMIN E PËRDITËSIMIT PJESOR TË PRONËS ME EMËRTIMIN FUSHË SPORTI, ME VENDODHJE KATUND I RI, ZK 2117**

Bazuar në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 500, datë 14.8.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjit Nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kërkesës për t’u drejtuar Këshillit të Ministrave për një ndryshim dhe shtesë të VKM- së nr. 431, datë 15.05.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Katundi i Ri, të Qarkut të Durrësit”, dhe miratimin e përditësimit pjesor të pasurisë me emërtimin fusha e sportit, që mban nr. 14 të listës së transferimit si më poshtë:



- a) Miratimin e ndryshimit të llojit të transferimit të pronës me nr. 14, miratuar me VKM nr.431, datë 15.05.2013, nga lloji i transferimit “në përdorim”, në llojin e transferimit “në pronësi”.
- b) Miratimin e përditësimit pjesor të pronës me nr. rendor 14, pjesë e listës përfundimtare, e miratuar me VKM-në nr. 431, datë 15.05.2013, sipas lidhjes 1, formularit të inventarizimit dhe planit të rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe janë pjesë përbërëse e tij, me qëllim për t’u përdorur për ushtrimin e funksioneve në fushën social-kulturore e sportive.
2. Bashkisë Durrës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t’ua tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.
3. Ngarkohet Drejtoria Ligjore (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve) për ndjekjen e procedurave të mëtejshme nëpërmjet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kjo në zbatim të ligji nr. 111/2018, “Për kadastrën”, ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 500, datë 14.8.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

### **KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 30.09.2022**



## Lidhja 1

### Bashkia Durrës, Njësia Administrative Katundi i Ri

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
14	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën social-kulturore e sportive	Në pronësi





# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Identifikoi: Per Bashkine Durres: Kadri Gjyli, Fatjon Zeqiri,


Ervis Bahiti, Ardiça Molla, Jemir Kurti, Anila Muhja (Specialite)  
Per ASHK-ne: Leonard Dervishi (Specialist)

Supervizoi: Irma Bushi  
Elio Jani  
Pergj. i Zyres se Pronave  
Drejtoria Ligjore

Aprovoi: Emiriana Sako  
Kryetar i Bashkise

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Bashkia : Durres  
Njesia Administrative Katundt I Ri  
Fusha e perdorimit te Prones: Sport



Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
14	2017 K-34-88-(193-D)	148/2	Truall	Terren sportiv Fshati Katund I Ri Bashkia Durres Njesia Administrative Katundt I Ri	13000 m2		Sport	Bashkia Durres	Bashkia Durres	



# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI "SHTET"

DATE \_\_\_\_\_.2022

QËLLIMI KALIM NË PRONËSI

**VENDNDODHJA**

BASHKIA DURRËS

DVASHK DURRËS

ZONA KADASTRALE 2117

NUMRI I PASURISË 148/2

INDEKSI I HARTËS K-34-88-(193-D)

**TË DHËNAT E PASURISË**

LLOJI I PASURISË

SIPËRFAQA E PASURISË = 13000 m<sup>2</sup>

ZONA KADASTRALE 2117

NUMRI I KATEVE

NUMRI I PEMËVE

**KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE**



SHPJEGUES  KONTURI SIPAS VKM  
 KONTURI I KËRKUAR NGA BASHKIA DURRËS SIPAS MATJEVE FAKTIKE

NR.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT
1.	V-					
2.	L-					
3.	J-					
4.	P-					

**REALIZOI PËR BASHKINË DURRËS**

PUNOI: KADRI GJYLI JETMIR KURTI

ARDITA MOLLAN ANILA MUHJA

ERVIS BAHITI FATJON ZEQIRI

NËNSHKRIMI

PËRGJEGJËS: IRMA RUSHI

NËNSHKRIMI

DREJTORI: ELIO JANI

NËNSHKRIMI

KRYETAR: EMIRIANA SAKO

NËNSHKRIMI/VULA

**REALIZOI PËR DVASHK**

SPECIALISTI: LEONARDO DERVISHI

NËNSHKRIMI:

**KONFIRMOI**

PËRGJEGJËS/DREJTORI: \_\_\_\_\_

NËNSHKRIMI/VULA

**TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z;O.**

KODE PËR TEKNOLOGJINË E MATJEVE: T- TERREN; Z- ZYRË; O-ORTOFOTO; G-GPS; S-STACION TOTAL; D-MATJE DISTANCASH

**PËRCAKTIMI I KUFIRIT:**

KODE PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT: P-PËRFAQËSUES I PRONARËVE; K-KUFITARËT TË GJITHË; KP-KUFITARËT PJSËRISHT; PB-PËRFAQËSUES BASHKIE, HK-HARTA KADASTRALE.

**SHËNIME TË VEÇANTA:**

PLANI I RILEVIMIT U HARTUA PËR REGJISTRIMIN E PRONËS DUKE U BAZUAR NË VKM 431 DATË 15.05.2013 "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËR FUNDIMTARËT E PRONAVE TË PALUAJTËSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KATUND I RI, TË QARKUR TË DURRËSIT", ME NUMËR LISTE 14 ME SIPËRFAQE 13000 M<sup>2</sup>

PRONAR/BASHKËPRONAR NËT- DEKLARIM MBI MARRËDHËNIEN ME KUFITARËT

EMRI MBIEMRI: \_\_\_\_\_

NËNSHKRIMI: \_\_\_\_\_





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 776/16 prot.

Durrës, më 07.10.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.101 datë 29.09.2022 :

Për miratimin e kërkesës për t'ju drejtuar Këshillit të Ministrave për një ndryshim të VKM Nr 431 dt 15.05.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Katund i ri, të qarkut të Durrësit” dhe miratimin e përditësimit pjesor të pronës me emërtimin Fushë Sporti, me vendndodhje Katund i ri ZK 2117.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI  
EMILJAN JANI**

